



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

## KOMISIONERI PUBLIK DHE SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT Z.EDMOND ISLAMAJ, GJYQATAR NË GJYKATËN E LARTË PARAQESIN KONKLuzionET PËRFUNDIMTARE

Me çeljen e seancës dëgjimore, fjala iu kalua Komisionerit Publik për të paraqitur konkluzionet përfundimtare. Z. Ballhysa theksoi se për pasurinë: kullotë 1000m<sup>2</sup>, në Kavajë, blerë në vitin 2015 në vlerën 137 mijë lekë, në bazë të ankimit të bërë ishte kërkuar verifikimi i dy elementëve, së pari: hetimi mbi historikun e transferimit të pronësisë nga shtet në privat dhe së dyti verifikimi i çmimit të zonës. Në lidhje me këto, KPA ka hetuar lidhur vetëm me kriterin e parë. Një tjetër problematikë lidhej edhe me pasuritë e bashkëjetueses së Z. Islamaj, e cila zotëronte: Ap. banimi 141m<sup>2</sup>, dyqan 55m<sup>2</sup> dhe garazh 16m<sup>2</sup>. Sipas Komisionerit Publik, bashkëjetuesja S.T në vitin 2005 nuk ka deklaruar asnjë nga këto pasuri dhe se për herë të parë këto pasuri janë deklaruar në deklaratën Vetting. Në ankimin e bërë, Komisioneri Publik ka kërkuar hetimin mbi mundësitë financiare të S.T në lidhje me këto pasuri, dhe hetimi në ZRPP Durrës së kur janë regjistruar këto pasuri. Sipas z. Ballhysa pretendimi i subjektit të rivlerësimit në seancën e datës 12.11.2018 se bashkëjetuesja e tij e ka bërë deklarinimin në vitin 2006 nuk rezultoi i saktë dhe se Z. Islamaj nuk ka provuar që të ardhurat e S.T të jenë të ligjshme. Komisioneri Publik citoi se subjekti i rivlerësimit në lidhje me këto 3 pasuri ka bërë deklarinim të pamjaftueshëm dhe s'ka vërtetuar ligjshmërinë e të ardhurave kjo bazuar në nenin 61 pika 3 e ligjit 84/2016. Lidhur me pasurinë e dhuruar dy fëmijëve të mitur me kontratën e dhurimit të datës 12.05.2017 nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, është kërkuar hetimi i mundësisë financiare të babait të z. Islamaj. Sipas subjektit të rivlerësimit, KPA duhej të kishte marrë në konsideratë deklarinimet e nënës së subjektit të rivlerësimit. Në lidhje me automjetin Opel Corsa dhe Mercedes Benz, S.T ka deklaruar shitjen e tyre në vlerë më të madhe nga sa ishin blerësi dhe nuk ishte paguar detyrimi tatimor. Lidhur me automjetin Land Rover blerë në vitin 2010 nga babai dhe subjekti i rivlerësimit, sipas Z. Ballhysa, subjekti i rivlerësimit kishte bërë deklarime kontradiktore në lidhje me blerjen e këtij automjeti. Deklaratat e marra në lidhje me shpenzimet e udhëtimeve në vitet 2004-2016, nuk janë paraqitur në formën e kërkuar nga ligji.

Komisioneri publik kërkoi prishjen e vendimit 22 datë 07.06.2018 të dhënë nga KPK dhe shkarkimin nga detyra të Z. Islamaj.

Gjithashtu edhe subjektit të rivlerësimit iu dha e drejta për të paraqitur konkluzionet e tij përfundimtare. Në lidhje me pasuritë: kullotë 1000m<sup>2</sup> pohoi se në 2015 ishte bërë ndarja dhe jo regjistrimi dhe nuk ka pasur shitje të njëpasnjëshme. Ai theksoi se për këtë pasuri komisioneri publik ka mbajtur qëndrime të ndryshme. Në lidhje me pasuritë e bashkëjetueses së tij S.T pohoi se deklarinimet janë bërë që në fillim, janë pasuri të fituara më trashëgimi nga gjyshi dhe babi i saj dhe nga puna në 2 OJF. Sipas tij Komisioneri Publik s'ka qenë i qartë në atë se çfarë ka kërkuar lidhur me pasuritë e bashkëjetueses së tij. Pohoi se nga shitja e dy automjeteve fitimi ka qenë i papërfillshëm dhe se automjeti Land Rover blerë nga ai dhe babi i tij ishte bërë me këste. Lidhur me analizën financiare theksoi se nuk duhet të shkelet standardi minimal dhe siguria juridike. Subjekti i rivlerësimit kërkoi lënien në fuqi të vendimit të dhënë nga KPK.

Në fund trupi gjykues deklaroi të mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe vendosi datën 22.05.2019 ora 15:00 për shpalljen e vendimit përfundimtar.